



Prot. Nr.: 88/3  
Tiranë, 3 Maj 2018

NR 230 PROT  
DI. 04-05-2018

Shumë të nderuar,

në vijim të takimit tonë datë 27 Prill 2018 në Kryeministri dhe sugjerimeve të dala prej tij, po Ju paraqesim bashkëlidhur kësaj shkrese, projekt marrëveshjen e hartuar nga Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi, bazuar në Ligjin e Kinematografisë dhe praktikën e shkollave homologe në Europë lidhur me bashkëpunimin institucional mes AFMM dhe QKK, të cilin Jua nisëm dhe në rrugë elektronike.

Duke Ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion tuaj ndaj sygjërimeve të mundëshme, në funksion të vizionit të Qeverisë Shqiptare.

Me respekt

Kujtim ÇASHKU  
Rektor

*Drejtuar:*

*Zonjës Mirela Kumbaro Furxhi*

*Ministër i Kulturës,*

*Zonjës Lindita Nikolla*

*Ministër i Arsimit, Rinisë dhe Sportit,*

*Zotit Engjëll Agaçi*

*Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave,*

*Zotit Ilir Butka*

*Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.*

*Objekti:*

*Përcjellje e Projekt Marrëveshjes mes AFMM dhe QKK*

**AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI**

Kinostudio - Rr. Aleksandër Moisiu nr.78 - Tiranë 1000, Shqipëria

Tel./Fax : +355 42 365 188/157

[info@afmm.edu.al](mailto:info@afmm.edu.al), [www.afmm.edu.al](http://www.afmm.edu.al)



**PROJEKT  
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
MES  
QENDRËS  
KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË  
DHE  
AKADEMISË  
SË FILMIT DHE MULTIMEDIAS  
MARUBI**

## NENI 1

### Dispozita të Përgjithëshme

Qendra Kombëtare e Kinematografisë, këtej e tutje **QKK**, me adresë Rruga Aleksandër Moisiu nr. 76, Kinostudio Tiranë, si person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Kulturës,

*dhe*

Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi, këtej e tutje **AFMM**, me adresë Rruga Aleksandër Moisiu nr. 78, Kinostudio Tiranë, si institucion jo publik i arsimit të lartë me Status të Veçantë i administruar nga shtëpia kinematografike OraFilm, në varësinë e Ministrit të Arsimit,

si institucione me qëllim e interes të përbashkët kinematografik, edukativ e kulturor, për të siguruar më tej qëndrueshmërinë e formimit, kualifikimit dhe profesionalizimit të kineastëve e autorëve të së ardhmes, përmes transmetimit të dijes e traditës më të mirë ndër breza të mësimdhënies të kinematografisë Shqiptare e asaj botërore,

në zbatim të Ligjit Nr.8096 datë 21.3.1996 ndryshuar me Ligjin Nr. 9353, datë 3.3.2005 "Për Kinematografinë",

sot, më datë \_\_Maj 2018 në Tiranë,

në prani të Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Kulturës, me vullnet të lirë e të plotë të palëve, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi institucional,

*mes:*

QKK, përfaqësuar me fuqi të plotë ligjore nga Kryetari zoti Ilir BUTKA,

*dhe*

AFMM, përfaqësuar me fuqi të plotë ligjore nga Drejtori i AFMM, Producenti zoti Kujtim ÇASHKU .

## NENI 2

### Të drejtat dhe detyrimet e palëve

QKK dhe AFMM do të bashkëpunojnë intensivisht dhe reciprokisht për implementimin e marrëveshjes së mëposhtme, në shërbim të intersit publik.

## NENI 3

QKK do të mbështesë AFMM përmes marrjes përsipër të një pjese të tarifës financiare të studentëve të cilët pranohen në konkursin vjetor të pranimit, me qëllim lehtësimin financiar të pranimit të studentëve në AFMM, vetëm në bazë të talentit, të dhënave dhe predispozitës për tu formuar dhe kualifikuar në zanatet e artit kinematografik, pa marë parasysh gjendjen financiare të kandidatëve për studentë.

**NENI 4**

Një përfaqësues i QKK, nëpunës, profesionist e specialist i lartë i kinematografisë, do të jetë anëtar i përhershëm në Këshillin e AFMM, me të drejtë vote.

**NENI 5**

Përfaqësuesi i QKK do të bëjë pjesë automatikisht dhe konsultohet rregullisht në të gjitha komisionet e përkohëshme të AFMM, si Komisioni i Konkursit të Pranimit, Komisioni i Vlerësimit të Punëve Teorike të Diplomave, por edhe në komisionet e përhershme, si Komisioni i Disiplinës dhe Etikës.

**NENI 6**

Përfaqësuesi do të jetë nëpunës i lartë i QKK dhe do të ketë akses të plotë dhe të përhershëm në dokumentacionin administrativ të AFMM.

**NENI 7**

AFMM çdo fillim viti akademik, pas miratimit nga Këshilli Akademik, do të paraqesë zyrtarisht në QKK për miratim, preventivin me kostot e studimeve mbi bazën e jo më shumë se 30 studentëve, në të tre vitet akademike së bashku, në të katër programet e studimit të Fakultetit dhe me bazë tarifore totale për student, jo më të lartë se 4200 euro të indeksueshme.

**NENI 8**

QKK do të kontribuojë financiarisht në buxhetin e AFMM me 56 % të buxhetit preventiv të paraqitur zyrtarisht nga AFMM.

**NENI 9**

Buxheti preventiv i paraqitur nga AFMM, pasi shqyrtohet, do të aprovohet nga Komisioni Financiar i QKK dhe do të miratohet nga Kryetari.

**NENI 10**

Në rast të hapjes së departamenteve dhe/ose programeve të tjera të studimit nga AFMM, përqindja e tarifës totale dhe numri maksimal i studentëve mund të ndryshojë, me kërkesë të AFMM dhe me konsultimin e QKK.

**NENI 11**

AFMM do të ulë tarifën e studimeve proporcionalisht me përqindjen e financimit nga QKK.

**NENI 12**

Në fund të çdo viti akademik AFMM dorrëzon në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit kopjet master negativ fizik apo numerik të filmave të prodhuar nga studentët e të tre viteve, dhe ruan kopje një Arkivën e saj.

**NENI 13**

Dokumentacioni Administrativ dhe ai i produksioneve, do të ruhet dhe dorrëzohet sipas rregullave për arkivat e shtetit.

**NENI 14**

Në të gjithë filmat e fundvitit të prodhuar dhe të përzgjedhur për shpërndarje, brenda dhe jashtë vendit nga Njësia e Produksioneve e AFMM duhet të figurojë fraza; me mbështetjen financiare të QKK.

**NENI 15**

Në lidhje me shpenzimin e fondit të financimit të QKK, AFMM, i nënshtrohet rregullave të shtëpive kinematografike.

**NENI 16**

Për fondet jo publike dhe ato që vijnë nga tarifa e studimeve, nga ana e fiskalitetit AFMM i nënshtrohet të gjitha rregullave ligjore mbi shtëpitë kinematografike në Shqipëri.

**NENI 17**

AFMM paraqet çdo vit në QKK një kopje të bilancit financiar të vitit ekonomik.

**NENI 18**

Me kërkesë të QKK dhe me konsultimin paraprak e miratimin e Drejtorit të AFMM, ambjentet dhe infrastruktura teknike e AFMM, do të vihet në përdorim pa shpërblim, për aktivitete kinematografike e kulturore të organizuara nga QKK, pa penguar dhe në koordinim me programin vjetor kulturor, akademik dhe atë të produksioneve të AFMM.

**NENI 19**

Në mjetet promociionale të këtyre ngjarjeve të QKK, do të figurojë fraza; me mbështetjen e AFMM.

**NENI 20**

QKK do të mbështesë financiarisht edhe projekte e specifike të veçanta kulturore të AFMM.

**NENI 21**

Nëpunës të QKK, kineastë profesionistë, kanë të drejtë të punësohen me kohë të pjesëshme në AFMM.

**NENI 22**

QKK do të mbështetet në burimet njerëzore të AFMM, për hartimin e analizave, studimeve, mbi kinematografinë, audiovizualin, imazhin, produksionin, distribucionin dhe tregun kulturor në përgjithësi.

**NENI 23**

Financimet për këto studime specifike ndahen mes QKK, Ministrisë së Kulturës dhe asaj të Arsimit dhe/ose institucioneve të tjera kulturore porositëse, që janë të interesuara.

**NENI 24**

QKK dhe AFMM do të bashkëveprojnë në mbështetje të Universiteteve Publike në shkallë vendi si dhe në trojet shqiptare jashtë Shqipërisë përfshirë dhe shkollat fillore e të mesme të cilat kanë, programe studimi mbi filmin dhe televizionin, si dhe të kulturës së imazhit si shkencë, si dhe stimulimin e hapjes së programeve të studimit në fushën e juris-prudencës, ekonomisë dhe financave mbi fushën audiovizuale, me mbështetje dhe ekspertizë të partnerëve vendas dhe Europianë.

#### **NENI 25**

QKK dhe AFMM do të bashkërendojnë punën dhe përpjekjet për rritjen e botimeve të librave profesionalë të autorëve Shqiptarë , të studimeve teorike mbi kinematografinë dhe median, si dhe përkthimet nga autorë botërorë të profilizuar në këto fushë.

#### **NENI 26**

AFMM dhe QKK do të bashkërendojnë punën dhe përpjekjet për hapjen e programeve të reja të studimit me rëndësi kombëtare prioritare afatshkurtër dhe afatmesme në fushën e produksionit, zërit në film si dhe aktrimin kinematografik, dhe afatgjata në fushën e zanateve të butaforisë së dekoreve, kostumografisë dhe aksesoreve, por edhe të filmit vizatimor dhe imazhit të animuar.

#### **NENI 27**

AFMM dhe QKK do të promovojnë aktivitetet e njëri-tjetrit, brenda dhe jashtë vendit, në të gjitha mjetet e komunikimit publik dhe rrjetet sociale.

#### **NENI 28**

##### **Dispozita kalimtare**

Pas rregjistrimit në Gjykatë të aktit të themelimit të Fondacionit "Kinostudio" nga Ministria e Arsimit dhe Shtëpia Kinematografike OraFilm, si dhe transformimit të AFMM nga Institucion i Arsimit të Lartë jo-publik në Institucion i Arsimit të Lartë Publik i Pavarur në varësinë e Fondacionit "Kinostudio", në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe të VKM nr.65 dt 02 Prill 2017, të gjitha funksionet dhe atributet që deri në firmosjen e kësaj marrëveshje i atribuohen Drejtorit të AFMM dhe Producentit të OraFilm, do t'i atribuohen Drejtorit Egzekutiv të Fondacionit "Kinostudio", si dhe të gjitha funksionet dhe atributet e Këshillit të AFMM, do t'i atribuohen Bordit të Administrimit të AFMM.

#### **NENI 29**

Drejtori i AFMM, Drejtori i Produksioneve dhe Përgjegjësit e Departamenteve, do të miratohen dhe emërohen nga Drejtori Egzekutiv të Fondacionit "Kinostudio", në konsultim me Bordin, Këshillin e AFMM, dhe QKK.

#### **NENI 30**

##### **Dispozita përfundimtare**

- i. Kjo marrëveshje është sui-generis, nominative dhe jo normative, për pasojë nuk përbën precedent.
- ii. Kjo marrëveshje është konsultuar para firmosjes nga QKK dhe AFMM me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë.
- iii. Kjo marrëveshje mund të amendohet, rishikohet dhe përditësohet, pjesërisht dhe/ose plotësisht, me kërkesën, konsultimin dhe miratimin e QKK dhe të AFMM, në partneritet, duke patur parasysh praktikën më të mirë dhe interesin publik, kinematografik, kulturor e kombëtar.
- iiii. Kjo marrëveshje hyn në fuqi, pas kundër-firmosjes nga Ministri i Kulturës dhe Ministri i Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe me publikimin e saj në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Nënshkruar në Tiranë, Dt.. Maj 2018

Për Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi

Zoti Kujtim ÇASHKU

Për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë

Zoti Ilir BUTKA

Në prani të Ministrit të Kulturës

Zonja Mirela KUMBARO FURXHI

Në prani të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Zonja Lindita NIKOLLA